



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2020:170215  
Datë: 11.03.2024  
Numri i dokumentit: 05434698

ARJ.nr.212/2023

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Beshir Islami, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësve F. S me adresë në “...”, nr., D., M.L., me adresë në “...” p.n. D., dhe Xh. K., me adresë në D., nr.,D., të cilët me autorizim i përfaqëson Valtida Shukriu, avokate nga Prizreni, kundër të paditurës së parë M.E., dhe A.,e R. K., (MEA), “Z.P”, nr. .,P., si dhe kundër të paditurës së dytë Z e RR.E., (ZRRE),“B.F”, kati i dytë, P., me palën e interesuar K.E., Sh.p.k. të cilën me autorizim e përfaqësojnë avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi nga Shoqëria e Avokatëve “Koci & Vokshi”, me adresë në Rrugën “Fehmi Agani” 46/2, Prishtinë, dhe me ndërhyrësit në anën e paditësve O.J..Q., “P” dhe G.S.J.,dhe P., (...., të cilët me autorizim i përfaqëson Valtida Shukriu, avokate nga Prizreni, me bazë juridike anulimin e vendimeve kontestuese të të paditurave, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësve dhe ndërhyrësve, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.484/2023 të datës 20.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05 Mars 2024, merr:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e ushtruar nga paditësit F.S, M.L dhe Xh.K., të gjithë nga D., dhe ndërhyrësve në anën e paditësve O..J..Q “...” dhe G.,për S.J dhe P., (GLPS), kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.484/2023 të datës 20.09.2023.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.484/2023 të datës 20.09.2023, është vendosur si në vijim: Në pikën I. APROVOHEN si të bazuara ankesat e të paditurës së parë M. E .A e R.K “Z.P”, nr. ., P., e datës 12.06.2023 dhe ankesa e të paditurës së dytë Z.RR.E., me adresë në Rrugën “B.F., kati i dytë, P., e datës 13.06.2023, si dhe ankesa e palës së interesuar “K.,” sh.p.k e datës 12.06.2023. Në pikën II. NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2081.2020, i datës 22.05.2023. Në pikën III. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve F. S me adresë në “T.

K, nr..D., M L., me adresë në Rrugën "...", pn. D., dhe Xh.K., me adresë në Rrugën e D, nr.., D., të cilët me autorizimi i përfaqëson Valtida Shukriu, avokate nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar anulimin e vendimeve kontestuese dhe licencave dhe atë: Vendimet e të paditurës së parë M.EkA (Leja ujore për HC B., L.U. ...., .../..., e datës 03.11.2020; Vendimi për Leje Ujore për HC D., L.U...., .../..., e datës 04.11.2020; Vendimi për Leje Mjedisore për HC B., ..../..., e datës 06.11.2020; Vendimi për Leje Mjedisore për HC D., ..../..., e datës 06.11.2020; Vendimi për Leje Ujore për HC L., ..., L.U. me numër protokoll 5058/20 e datës 03.02.2021; Vendimet e të paditurës së dytë Z. R., për E., (Vendimi V\_1303\_2020, i datës 12.11.2020; Vendimi V\_...\_..., i datës 12.11.2020; Licencë për Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC D., Li\_.../..., e datës 12.11.2020 dhe Licencë për Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC B., Li\_ ..../..., e datës 12.11.2020).

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.484/2023 të datës 20.09.2023, paditësit F S., M.L., dhe XH. K., të gjithë nga D., dhe ndërhyrësit në anën e paditësve OJQ ".." dhe G.,për S., J.,dhe P., (GLPS), përmes të autorizuarës së tyre Valtida Shukriu, avokate nga Prizreni, në afat ligjor në këtë gjykatë parashetrojnë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e kontestojnë ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Propozojnë që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të anulohet aktgjykimi AA.nr.484/2023, i datës 20.09.2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor ka ushtruar e paditura e dytë Z. RR., për E., (ZRRE), me të cilën ka kërkuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.484/2023 të datës 20.09.2023.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor ka ushtruar edhe pala e interesuar K.E., Sh.p.k, përmes të autorizuarit të saj Sh.A., "K & V"., me avokatët A. K., dhe G. V., dhe me të cilën ka kërkuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor AA.nr.484/2023 të datës 22.05.2023 dhe i njëjti të vërtetohet si i drejtë dhe ligjor.

Përgjigje në kërkesë nuk ka ushtruar pala e paditur M.E.A., (MEA).

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësve dhe ndërhyrësve, përgjigjes në kërkesë të paditurës ZRRE dhe palës së interesuar K. E.,Sh.p.k, si dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se procedurës së ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, procedurës së licencimit dhe operimit të ndërmarrjes, këtu palës së interesuar K. E., Sh.p.k, në

aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, nga burimet e ripërtërishme – uji, i kanë paraprirë një varg procedurash administrative.

Kështu, Bordi i Z.RR., për E., këtu të paditurës së dytë, me datë 11 nëntor 2010, i ka lëshuar ndërmarrjes, këtu palës së interesuar, K.E., Sh.p.k, Vendimin V\_296\_2010, Njoftim mbi Autorizim Preliminar, pasi që është konstatuar se ndërmarrja “K - E”, sh.p.k. ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga burimet e ripërtërishme të energjisë (BRE) nga uji, për HC “B”, HC “D”, dhe HC “L II”, dhe të njëjtën e ka udhëzuar për përmbushjen e kërkesave tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Ndërsa, me Vendimin V\_402\_2012 të datës 15.06.2012, ndërmarrjes K.E., Sh.p.k, i lëshon Autorizimin me kohëzgjatje prej dy (2) vite, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 17.6 MW që përbëhet prej dy (2) njësi gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC “B” ,me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, dhe HC “D”, me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, në komunën e D., pasi ka konstatuar se Ndërmarrja K.E., Sh.p.k, i ka përmbushur të gjitha kërkesat ligjore siç përcakton Rregulla ZRRE/Nr.11/2017 dhe legjislacioni në fuqi, përkatësisht dokumenteve të kërkuara nga ZRRE dhe të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës - kontratave, lejeve, pëlqimeve, vendimeve të lëshuara nga institucionet përgjegjëse, të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të administruara nga gjykata e shkallës së parë. Ndërsa për HC “L II” ,me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW dhe e cila ishte pjesë e aplikacionit, Bordi i Zyrës së R., për E., ka konstatuar se kërkesa do të shqyrtohet dhe vendoset pas sjelljes së Lejes së Ndërtimit dhe Lejes Ujore.

Me Vendimin V\_568\_2013, të datës 24.10.2013, ky bord, lëshon Autorizimin edhe për njësinë gjeneruese HC L II., me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, në Komunën e D., pasi konstaton se i ka përmbushur të gjitha kërkesat ligjore siç përcakton Rregulla ZRRE/Nr.11/2017.

Tutje, konform lejes ndërtimore dhe lejeve ujore të ndryshuara (Vendimet Nr.1287/16-ZSP-356DU/16 dhe Nr.1287/16-ZSP-355DU/16 të lëshuar nga MMPH), të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe legjislacionit në fuqi, Bordi i ZRRE, ka nxjerrë Vendimin V\_813\_2016 të datës 19.05.2016, për Modifikimin e Autorizimit Final V\_402\_2012 të datës 15.06.2012, për HC Belaja nga kapaciteti fillestar i instaluar prej 9.2 MW në kapacitetin instalues prej 8.06 MW dhe për HC D., nga kapaciteti fillestar i instaluar prej 8.4 MW në kapacitetin instalues prej 9.8 MW.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë duke vepruar sipas kërkesës - aplikacionit të ndërmarrjes, K.E., Sh.p.k të datës 24.02.2016, për Licencim të aktivitetit të prodhimit të Energjisë Elektrike, me vendimet V\_1182\_2019, V\_1183\_2019 V\_1184\_2019, të datës 14.10.2019, konform nenit 5 dhe 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, i ka lëshuar Licencë të përkohshme për prodhim të Energjisë nga HC L ..., HC D., HC B., për periudhën nga 14.10.2019 deri me 13.10.2020, pasi ka konstatuar se ndërmarrja i ka plotësuar kushtet për licencim përveç lejes mjedisore të cilën është obliguar që brenda afatit prej 12 dymbëdhjetë muajsh ta dërgoj në Rregullator.

Meqenëse ndërmarrja K.E Sh.p.k brenda afatit ligjor të përcaktuar si në licencën e përkohshme kishte dështuar të sigurojë lejen mjedisore ndërsa afati i licencës së përkohshme kishte skaduar,

ZRRE me datë 13.10.2020 i kishte ndërprerë të njëjtës operimin ndërsa pas dorëzimit në Rregullator të Vendimeve për Leje Mjedisore të lëshuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, me Ref.nr.5837/19/MEA të datës 06.11.2020 për HC Deçani dhe Ref.nr.5637/19/MEA të datës 06.11.2020 për HC B., ndërmarrja K.E., Sh.p.k, pajiset me Licencë Afatgjatë për periudhën 40 vjeçare, Vendimi V\_1303\_2020, i datës 12.11.2020 dhe Licencë për Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC D., Li\_49/20, të datës 12.11.2020 si dhe Vendimi V\_1304\_2020, i datës 12.11.2020 dhe Licencë për Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC B., Li\_50/20 të datës 12.11.2020.

Ndërmarrja K.E., Sh.p.k në mënyrë që të finalizojë investimin e tij në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme (BRE) – uji, ka aplikuar dhe ka siguruar ndër të tjera edhe lejet përkatëse, nga e paditura e parë M.E., dhe A., (MEA), të cilat kontestohen nga paditësit me padi siç janë:

Leja ujore për HC Belaja, L.U.13, 4981/20, të datës 03.11.2020, e cila i është lëshuar në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite, me mundësi vazhdimi. Sipas së cilës, K.E., Sh.p.k merr përsipër detyrimin e hartimit të Raportit të Studimit të PPE-së - Prurjes së pranueshme Ekologjike dhe Planit të Veprimit të HC B., të dyja në afat kohor prej 60 ditësh;

Leje Ujore për HC D, L.U.14, .../..., të datës 04.11.2020, e cila i është lëshuar në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite, me mundësi vazhdimi, me detyrimin e hartimit të Raportit të Studimit të PPE-së – Prurjes së pranueshme Ekologjike dhe Planit të Veprimit të HC D., të dyja në afat kohor prej 60 ditësh;

Leje Mjedisore për HC B., .../.../..., të datës 06.11.2020 dhe pajimet përcjellëse: gypat, kabllot elektrik dhe fibrat optik përgjatë rrugës publike, zona kadastrale D., për periudhën 5 (pesë) vjeçare, pasi ka konstatuar se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore;

Leje Mjedisore për HC Deçani, .../.../..., të datës 06.11.2020 dhe pajimet përcjellëse: gypat, kabllot elektrik dhe fibrat optik përgjatë rrugës publike, zona kadastrale D., për periudhën 5 (pesë) vjeçare, pasi ka konstatuar se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore;

Leje Ujore për HC ..., L.U..., .../..., të datës 03.02.2021, e cila i është lëshuar në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite, me mundësi vazhdimi.

Kundër vendimeve të licencimit të paditurës ZRRE, lejeve ujore dhe mjedisore të MEA, të lëshuara për ndërmarrjen K.E., sh.p.k, këtu palën e interesuar, paditësit me padi fillojnë konflikt administrativ duke e kontestuar ligjshmërinë e tyre.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.2081/2020, të datës 22.05.2023, në dispozitiv ka vendosur si në vijim: Në pikën I. APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve F.S., “T.K, nr..., D, M.L., me adresë në Rrugën “M.B”, pn. D dhe Xh.K., “Rr D”., nr...,D., Në pikën II. ANULOHEN Vendimet e të paditurës së parë M.E., dhe A., si në vijim: 1.Leja ujore për HC B.,L.U..., .../..., e datës 03.11.2020; 2.Vendimi për Leje Ujore për HC D., L.U..., .../..., e datës 04.11.2020; 3.Vendimi për Leje Mjedisore për HC B, .../.../ZSP, e datës 06.11.2020; 4.Vendimi për Leje Mjedisore për HC Deçani, .../.../ZSP, e datës 06.11.2020; 5.Vendimi për Leje Ujore për HC L ..., L.U. me numër protokollit .../..., e datës 03.02.2021; Në pikën III. ANULOHEN Vendimet e të paditurës së dytë Z...,e R., për E.,1.Vendimi V\_1303\_2020, i datës 12.11.2020; 2.Vendimi V\_1304\_2020, i datës 12.11.2020; 3.Licencë për

Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC D, Li../..., e datës 12.11.2020 dhe 4.Licencë për Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC B..., Li../..., e datës 12.11.2020. Në pikën IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Nga vendimet e kontestuara del se ato përmbajnë të meta të tilla të përcjellura me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë që akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi të përmbajnë pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes, pjesën urdhëruese apo dispozitivin, që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit, pjesën arsyetuese dhe pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij apo këshillën juridike.

Tutje theksohet se: gjykata gjeti se vendimi i të paditurës së dytë nën shenjën V\_1303\_2020 i datës 12.11.2020 ashtu edhe vendimi nën shenjën V\_1304\_2020 i datës po ashtu 12.11.2020, është i përfshirë me shkelje ligjore nga neni 47, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke mos përcaktuar informacionin se në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë. Përveç kësaj, e paditura e dytë, duke qenë në dijeni të plotë se akti administrativ i së njëjtës, paraqet akt përfundimtar në procedurë administrative, ka lëshuar të orientoj qartë palët e interesuara se ndaj këtij vendimi përfundimtar, kompetente për të vlerësuar ligjshmërinë e së njëjtës është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Obligimi i qartësimi se në cilën Gjykatë dhe cilin Departament brenda Gjykatës mund të ngritën pretendimet e palëve të interesuara, po ashtu buron nga neni 9, paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në të cilin përcaktohet qartë si në vijim: “Neni 9 - Parimi i administratës së hapur, 2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj”.

Tutje, thuhet se: gjykata gjeti se e paditura e parë me rastin e marrjes së vendimeve kontestuese, përkatësisht të lejes ujore për HC D., L.U. 1... ../..., të datës 04.11.2020 dhe Lejes Ujore për HC L., ..., L.U., numër protokoli ../..., e datës 03.02.2021, gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, duke zbatuar nenin 71 të Ligjit Nr.05/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe duke i lëshuar palës së Interesit K..E., Sh.p.k, në mënyrë të paligjshme lejet Ujore për prodhimin e energjisë elektrike. Në këtë drejtim gjykata gjeti se Lëshimi i lejeve ujore nga e paditura e parë për prodhimin e energjisë elektrike, është bërë në kundërshtim me nenin 78, paragrafin 1, 2, 3, nën-paragrafin 3.2 të Ligjit Nr.05/L-147 për Ujërat e Kosovës. Në lidhje me këtë, gjykata gjeti se procedura e fitimit të lejes ujore, mbi bazën e shfrytëzimit të fuqisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike, nuk është bërë në përputhje me nenin 70 paragrafin 1, nën-paragrafin 1.2 dhe paragrafin 3 të Ligjit Nr.05/L-147 për Ujërat e Kosovës, i cili në ndërlidhje me nenin 78,

paragrafin 1, 2, 3 nën-paragrafin 3.2 të po të njëjtit ligj, ka obliguar të paditurën e parë që në rastet e tilla të zbatohet procedura e koncensionimit, përkatësisht partneritetit publiko-privat, veprime këto që nuk janë marrë, përkatësisht janë anashkaluar nga e paditura e parë e që lëshimi i lejeve ujore duke respektuar procedurën e koncensionimit do të nënkuptonte krijim të kushteve të barabarta për të gjithë operatorët ekonomik e investitorë të brendshëm e të jashtëm që në kushte të barabarta konkurrojnë në projekte të tilla.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, Lejet mjedisore të lëshuara nga e paditura e parë, janë dhënë në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, me zbatimin e së cilës dispozitë ligjore do të mundësohej rehabilitimi i mjedisit rreth së cilit janë ndërtuar hidrocentralet në fjalë. Në lidhje me këtë, gjykata i fali besimin e plotë Raportit të Grupit Punues për Shqyrtimin e Procedurave administrative të zbatuara për hidrocentralet dhe ndikimin e tyre në ujëra dhe mjedis të 30 Qershorit 2021, ku në pikën 14 të këtij Raporti, në mënyrë decisive konstatohet si në vijim: *“Eksplotimi i zhavorrit dhe rërës në lokacionin “Zalli i Rupës” është bërë në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 4 dhe neni 128 paragrafi 3 të Ligjit për mbrojtjen e Natyrës në vitin 2010 dhe gjatë vazhdimit të procedurave të lëshimit të akteve tjera administrative nuk është zbatuar neni 10 i UA. Nr. 04/2016 për mbrojtjen e brigjeve të ujë rrjedhave”*. Sa i përket gjetjes së tillë të eksploatimit të zhavorrit dhe rërës në vendin e quajtur “Z.R”, asnjëra nga organet e paditura, duke përfshirë edhe palën e interesit K.. E., Sh.p.k, as me përgjigjet në padi dhe as gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk arriti të ofroj dëshmi të kundërta para Gjykatës rreth pretendimeve të palës paditëse dhe ndërhyrësve që një eksploatim i tillë i jashtëligjshëm, ka ndodhur. Për këtë qëllim, gjykata detyron të paditurën e parë, që në përputhje me autorizimet e veta ligjore, të mundësoj krijimin e trupave apo mekanizmave ad-hoc, mandati i së cilëve do të ishte identifikimi, raportimi dhe sanimi i të gjitha dëmeve mjedisore të shkaktuara nga pala e interesit K.. E., Sh.p.k. duke përfshirë por duke mos u kufizuar në dëmet mjedisore të shkaktuara në vendin e quajtur “Z i R”, dhe në të gjitha mjediset tjera, ku është konstatuar shkaktimi i dëmit mjedisor, duke detyruar palën e interesit K.. E., Sh.p.k. apo cilindo subjekt publik apo privat, që të sanoj apo riparoj të gjitha dëmet e shkaktuara mjedisore të bëra gjatë apo pas ndërtimit të hidrocentraleve. Dëmet mjedisore të shkaktuara nga operimi i hidrocentraleve, gjykata i vërtetoi edhe përmes administrimit në cilësi të provave materiale edhe të dyzetë e pesë [45] fotografive të dorëzuara si provë nga ana e paditësve dhe ndërhyrësve, me parashtrësën e datës 27.04.2023.

Në fund thuhet se, duke marrë parasysh që vendimet e të paditurës së parë janë marrë në mënyrë të kundërligjshme, gjykata gjeti se edhe vendimet e të paditurës së dytë janë marrë me aplikim jo të drejtë të dispozitave ligjore, duke përmbushur kështu të gjitha elementet e nevojshme për tu kundërshtuar dhe rrjedhimisht për tu anuluar, konform nenit 16, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1. të Ligjit për Konfliktet Administrative. Të gjitha vendimet e të paditurës së dytë për licensë mbështeten në lejet ujore dhe mjedisore që janë akte të paligjshme. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se lëshimi i licensave nga ana e Z., së Rr., për E., për dyzetë [40] vite, duke u bazuar në nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë i cili përcakton: “1. Licenca mund të jepet për periudhën kohore deri në dyzet (40) vjet”, është interpretim i gabuar ashtu siç është interpretim i përgjithësuar dhe i gabuar i të paditurit të dytë edhe konstatimi se: “ZRRE ka lëshuar licensa të prodhimit për periudhën 40 vjeçare, sepse Licensa është e drejtë për ushtrim të aktiviteteve, në pajtim me kushtet ligjore dhe legjisllacionit në fuqi”. Në lidhje me këtë gjykata gjeti se e paditura e dytë gabimisht ka interpretuar dhe zbatuar nenin 32, paragrafin 1 dhe 2.1 të Ligjit për

Rregullatorin e Energjisë, për faktin që kjo dispozitë ligjore, përcakton vetëm kufirin maksimal të dhënies së lejes në rastet e prodhimit të energjisë elektrike e që afatin maksimal i dhënies së Licensës nuk mund të kaloj 40 vite. Në lidhje me këtë gjykata gjeti se e paditura e dytë, ka dështuar të ndërlidhë afatin për dhënien e Licensës për operim me afatin e vlefshmërisë së Lejes Mjedisore, duke qenë se Leja Mjedisore ishte parakusht formal për dhënien e Licensave nga ZRRE. Në këtë drejtim, argumentet e të paditurës së dytë se Licença do të revokohej në rast se Operatori Ekonomik nuk do të plotësonte kushtet e Lejes Mjedisore pas kalimit të afatit prej pesë vitesh, u refuzuan si të pabaza.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke shqyrtuar aktgjykimin brenda kufijve të ankesës e duke u nisur nga gjendje e tillë e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, andaj me vlerësimin ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e pabazuar, për çka në këtë rast janë plotësuar kushtet e parapara ligjore që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë ndër të tjera theksohet se: kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke i pasur parasysht edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktore me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet e aktgjykimit apo nëse ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*.

Sipas kolegjit të Apelit, aktgjykimi i ankimuar, përmban shkelje edhe sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë, duke mos i vlerësuar provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe duke mos i vlerësuar vendimet e të paditurës, konform dispozitave ligjore në fuqi, ka rënë ndesh me nenin 183 paragraf 1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare”*.

Sipas vlerësimit të kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë, qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, nuk është i rregullt dhe i bazuar nga shkakun se aktet kontestuese me padi nga paditësit, janë në harmoni me Legjislacionin procedural dhe material, në fuqi, dhe të njëjtat kanë kaluar nëpër procedurë të rregullt administrative, dhe të njëjtat janë të ekzekutueshme dhe të ligjshme. E gjithë procedura e zhvilluar pranë organeve administrative që nga paraqitja e kërkesës e deri tek marrja e vendimeve dhe lejeve ujore të kontestuara me padi, është e rregullt dhe e ligjshme, të cilat nuk kanë nevojë me prova të argumentohen se janë ligjore, dhe të njëjtat janë akte përfundimtare në procedurë administrative andaj si të tilla vërtetohen edhe nga kolegji i Apelit.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike gjykata e shkallës së dytë vlerëson se refuzimi i kërkesëpadisë së paditësve është bërë në kuptim të mos plotësimit të kushteve ligjore dhe vlerësimit të gabuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ngase përveç që nuk kemi akt administrativ të kundërligjshëm në rastin konkret, kemi një procedurë të ligjshme administrative në raport me marrjen e vendimeve kontestuese dhe si e tillë vlerësohet edhe nga kolegji. Pretendimet e palëve në ankesa janë të bazuara dhe të njëjtat i përkrahë dhe i vlerëson edhe kolegji sepse të njëjtat janë të bazuara edhe në provat të cilat i janë bashkangjitur e të njëjtat gjenden edhe në shkresat e lëndës, kërkesëpadija e paditësve është refuzuar si e pabazuar, nga shkaku se pretendimet e paditësve lidhur me vendimet kontestuese janë të pabazuara, dhe të njëjtat nuk mund ti përkrahë kolegji andaj refuzohen, pasi që sipas kolegjit të Apelit, kërkesëpadija e paditësve në tërësi është e pa bazuar, në fakte dhe prova, dhe e njëjta si tillë nuk mund të qëndrojë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, si dhe përgjigjeve në kërkesë, gjen se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vendosur me aprovimin si të bazuar të ankesës së paditurës së parë MEA dhe të paditurës së dytë ZRRE dhe ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Kjo Gjykatë e vlerëson si të drejtë qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit, pasi që aktgjykimi i kontestuar nuk është përfshirë me shkelje të pretenduara të dispozitave të procedurës administrative dhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale ashtu si pretendojnë paditësit dhe ndërhyrësit në kërkesë.

### **Ligji Nr.05/L-081 për Energjinë**

Sipas nenit 3 të Ligjit Nr.05/L-081 Për Energjinë përcaktohet se: *“1.Përkufizimet: 1.29. Licenca - dokument i lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që i mundëson bartësit të licencës të ushtrijë aktivitetet në sektorin e energjisë për të cilat nevojitet licenca në përputhje me dispozitat e ligjeve që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë; 1.58. Zyra e Rregullatorit për Energji - Rregullatori) – është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë”. “2. Të gjitha veprimtaritë energjetike në sektorin e energjisë ushtrohen në bazë të licencave të lëshuara nga Rregullatori, përveç aktiviteteteve për të cilat nuk kërkohet licencë, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë”.*

### **Ligji Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike**

Sipas nenit 6 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, përcaktohet se: *“Prodhimi i energjisë elektrike 2. Prodhuesit e energjisë elektrike të cilët kanë licencë për prodhimin e energjisë elektrike mund të prodhojnë energji elektrike në regjim pune bazë apo regjim variabil, përfshirë energjinë për mbulimin e humbjeve në rrjetin transmetues dhe të shpërndarjes, energjinë për balancim të sistemit dhe energjisë për shërbime ndihmëse”.*

Sipas nenit 7 të këtij ligji përcaktohet se: *“Obligimet dhe të drejtat e prodhuesve të energjisë elektrike. “1. Prodhuesit e energjisë elektrike janë të obliguar: 1.1. t’iu përmbahen të gjitha kushteve të përcaktuara në licencë për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit, nëse një licencë e tillë kërkohet. 2. Prodhuesit e energjisë elektrike, me kusht që t’i përmbahen dispozitave të këtij Ligji, Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, licencave, kodeve dhe rregullave tjera relevante, të cilat miratohen nga Rregullatori, kanë të drejtë të: 2.1. shfrytëzojnë burimet e energjisë që i*



*konsiderojnë më të përshtatshme për procesin e prodhimit në centralin elektrik të tyre, me kusht që shfrytëzimi i burimeve në fjalë të jetë në përputhje me të gjitha kushtet relevante teknike, mjedisore dhe të efikasitetit të energjisë; 2.2. lidhin centralet e tyre me sistemin e transmetimit apo sistemin e shpërndarjes në pajtim me kushtet dhe rregullat përkatëse; 2.3. shesin energjinë elektrike sipas dispozitave të këtij ligji akteve tjera dhe në veçanti Rregullave të Tregut; 2.4. blejnë energjinë elektrike për nevoja të veta; 2.5. kenë qasje në sistemin e transmetimit dhe të shpërndarjes sipas rregullave dhe kushteve përkatëse; 2.6. faturojnë dhe inkasojnë pagesat, sipas kontratave të nënshkruara për të gjitha shitjet e energjisë elektrike, kapacitetet, shërbimet ndihmëse dhe shërbimeve tjera të kontraktuara”.*

### **Ligji Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë**

Sipas nenit 28 të Ligjit Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, përcaktohet se: *“Obligimi i nxjerrjes së licencës 1. Aktivitetet e energjisë, kryhen nga ndërmarrjet për energji në bazë të licencave të lëshuara nga Rregullatori. 2. Licencat e lëshuara nga Rregullatori kërkohen për kryerje të aktiviteteve të energjisë në Republikën e Kosovës. Varësisht prej kërkesave të Ligjit për Energjinë Elektrike, Ligjit për Gazin Natyror dhe Ligjin për Energjinë Termike, licencat e lëshuara mund ta mbulojnë më shumë se një aktivitet të shënuar në vijim: 2.1. prodhimin e energjisë elektrike”;*

Sipas nenit 30 të këtij ligji përcaktohet se: *“Kriteret për licencë dhe kushtet e licencës 1. Licenca lëshohet vetëm për ndërmarrjet e energjisë të regjistruara sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, të cilat: 1.1. posedojnë mundësitë teknike e financiare, burimet materiale e njerëzore dhe strukturën organizative për plotësimin e kërkesave të rregullave të licencës; 1.2. kanë të drejta pronësie ose të drejta ligjore për shfrytëzimin e stabilimenteve të energjisë me të cilat kryhen aktivitetet; 1.3. sigurojnë fakte që stabilimentet e energjisë që përdoren për aktivitete të plotësojnë kërkesat për mbrojtje të shëndetit, sigurisë dhe mjedisit; 1.4. nuk janë në paaftësi të pagimit apo në proces të likuidimit apo falimentimit; 1.5. nuk i është hequr licenca për të njëjtin aktivitet brenda pesë (5) viteve para datës së parashtrimit të aplikacionit”.*

Sipas nenit 32 të këtij ligji përcaktohet se: *“Kohëzgjatja e licencave 1. Licenca mund të jepet për periudhën kohore deri në dyzet (40) vjet. 2. Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e licencës përcaktohet si vijon: 2.1. për aktivitetet e prodhimit të energjisë elektrike, energjisë termike, apo për bashkëprodhimin e energjisë elektrike dhe energjisë termike, transmetimin e energjisë elektrike apo gazit natyror, apo shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë termike apo gazit natyror, apo deponimit të gazit natyror, rregullohet varësisht nga jetëgjatësia e asetëve të përdorura për kryerjen e aktiviteteve relevante me kohëzgjatje që nuk mund të tejkalojë periudhën dyzet (40) vjeçare”.*

Sipas nenit 34 të këtij ligji përcaktohet se: *“Procedura e lëshimit të licencës 1. Procedura për marrjen e licencës fillon me dorëzimin e kërkesës me shkrim në Rregullator, të shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës, në pajtim me rregullat mbi licencimin, të specifikuara në nenin 38 të këtij ligji”.*

Sipas nenit 37 të këtij ligji përcaktohet se: *“Ndërprerja apo pezullimi i licencës 2. Rregullatori mund të tërheqë licencën nëse: 2.1. i licencuari dështon t'i përmbushë apo shkel kushtet apo detyrimet materiale të përcaktuara me licencë, dhe nuk korrigjon dështimet e tilla brenda një afati të caktuar nga Rregullatori”.*

Sipas nenit 38 të këtij ligji përcaktohet se: *“Rregullat dhe kriteret e licencimit 1. Rregullatori harton, miraton dhe publikon rregullat që përcaktojnë kriteret e paraqitura në nenin 30 paragrafi 2 të këtij ligji, dhe përshkruajnë kushtet dhe procedurat për nxjerrjen, ndryshimin, bartjen, pezullimin apo ndërprerjen e licencës si dhe të drejtat dhe detyrimet që do të përfshihen në licencë”*.

### **Ligji Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës**

Sipas nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, *“Përkufizimet pika 1.9. përcaktohet se: “Koncesioni – formë kontrate me shkrim, me të cilën autoritetet kompetente lejojnë bartësin e koncesionit, të gëzojë ndonjë të drejtë ekskluzive për nxjerrjen, shfrytëzimin dhe shkarkimin e ujërave, sipas kushteve të koncesionit”. Pika 1.12. përcaktohet se: “Leje ujore – e drejtë e dhënë me shkrim nga institucionet e përcaktuara me këtë ligj për të përdorur apo shkarkuar një sasi uji për një qëllim dhe kohë të caktuar”*.

Sipas nenit 5 të këtij ligji përcaktohet se: *“Administrimi me ujëra është veprimtari me interes shtetëror që kryhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji”*.

Sipas nenit 27 të këtij ligji përcaktohet se: *“Shfrytëzimi i ujërave 1. Shfrytëzimi i ujërave përfshinë aktivitetet e marrjes, nxjerrjes, akumulimit, ndryshimit të drejtimit të rrjedhave sipërfaqësore dhe nëntokësore për: 1.2. prodhimin e energjisë elektrike”*.

Sipas nenit 28 të këtij ligji përcaktohet se: *“Përparësitë për shfrytëzimin e ujërave 1. Nëse ka më tepër se një kërkesë për shfrytëzimin e ujit nga një trup i njëjtë ujqor, për të cilin nuk është dhënë leje për shfrytëzimin e ujit, leja lëshohet sipas këtyre prioriteteve: 1.4. nevojat e prodhimit të energjisë elektrike dhe nevojat tjera motorike”*.

Sipas nenit 70 të këtij ligji përcaktohet se: *“Fitimi dhe kushtet e fitimit të së drejtës ujore 1. Fitimi i së drejtës ujore, sigurohet: 1.1. me leje ujore; 1.2. me koncesion. 2. Bartësi i të drejtës ujore shfrytëzon ujin sipas kriterëve të përcaktuara me aktin për fitimin e së drejtës ujore. 3. Koncesioni, përkatësisht partneriteti publik dhe privat kryhet në kushte, mënyra dhe procedura për ndarjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujërave të caktuara me këtë ligj dhe legjisllacionin në fuqi”*.

Sipas nenit 71 të këtij ligji përcaktohet se: *“Procedurat për lëshimin e lejes ujore 1. Procedura për fitimin e lejes ujore është: 1.1. Kushtet ujore; 1.2. Pëlqimi ujqor; 1.3. Leja ujore. 1.4. Urdhëresa Ujqore”*.

Sipas nenit 72 të këtij ligji përcaktohet se: *“Leja ujore 1. Leja ujore lëshohet për: 1.7. përdorimi i ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale; 7.Leja Ujqore rishqytohet së paku në çdo pesë (5) vjet”*.

Sipas nenit 73 të këtij ligji përcaktohet se: *“Kohëzgjatja e lejes ujore 1. Leja ujore lëshohet me afat kohor të caktuar, varësisht nga lloji i objektit dhe pajisjeve si dhe qëllimit të shfrytëzimit të ujit, por jo më gjatë se pesëmbëdhjetë (15) vjet, përveç lejes për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtretërit dhe brigjet e trupave ujqorë sipërfaqësorë, që lëshohet me kohëzgjatje vetëm një (1) vit, me mundësi vazhdimi varësisht nga prurjet e aluvionit në trupin ujqor. 2. Në rastin e dhënies së lejes ujore për nevoja energjetike afati i lejes mund të jetë deri në dyzet (40) vjet. 3. Kohëzgjatja e lejes ujore fillon nga momenti i fillimit të veprimit juridik të lejes ujore”*.

Sipas nenit 77 të këtij ligji përcaktohet se: *“Procedura e marrjes dhe pushimit të Lejes Ujore Ministri me akt nënligjor, do të përcaktojë më hollësisht: procedurën, përmbajtjen, formën, kushtet, mënyrën, ruajtjen dhe çështjet tjera me rëndësi, lidhur me dhënjen dhe humbjen e të drejtës së lejes ujore”.*

Sipas nenit 78 të këtij ligji përcaktohet se: *“Veprimtaritë për të cilat ndahet koncesioni për shfrytëzimin e ujërave 1. Veprimtaritë afariste të cilat realizohen me shfrytëzimin e ujit nga trupat ujorë sipërfaqësor dhe nëntokësorë, realizohen përmes ndarjes së koncesionit, në pajtim me ligjin. 5. Lidhur me procedurat për ndarjen e koncesionit si dhe çështjet tjera lidhur me koncesionin, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga ky ligj, përfshirë aktin nënligjor për leje ujore dhe legjislacionin në fuqi për koncesion.*

Sipas nenit 79 të këtij ligji përcaktohet se: *“Koncesioni ndahet përmes konkursit publik të organizuar dhe realizuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”.*

### **Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit**

Sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, lidhur me përkufizimet përcaktohet se: *“Leje mjedisore” është dokument me shkrim i lëshuar nga Ministria me këtë ligj, e kërkuar më qëllim që të merret leja e punës. “Vlerësimi i ndikimit në mjedis” (VNM) është procesi i cili vlerëson përcaktimin e dëmeve të mundshme mjedisore nga ndërtimi dhe aktivitetet tjera. “Sanimi” është proces i ndërmarrjes së masave për ndalimin e ndotjes dhe degradimin e mëtutjeshëm të mjedisit deri në nivelin i cili është i sigurt për shfrytëzim të mëtutjeshëm të lokacionit, duke përfshirë, rregullimin e hapësirës, revitalizimin dhe rikultivimin”.*

Sipas nenit 9 të këtij ligji përcaktohet se: *“Mbrojtja e resurseve natyrore 1. Mbrojtjen e resurseve natyrore e sigurojnë institucionet e Kosovës në përputhje me ligjet e kësaj fushe si dhe përmes: 1.4. Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)”.*

Sipas nenit 10 të këtij ligji përcaktohet se: *“Pëlqimi për shfrytëzim 1. Asnjë institucion nuk mund ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor. 2. Pëlqimin nga paragrafi 1. të këtij neni e jep Ministria”.*

Sipas nenit 31 të këtij ligji përcaktohet se: *“Leja Mjedisore 1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore. 2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesë vjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë. 3. Ministria, me akt nënligjor, përcakton aktivitetet e nevojshme për lëshimin e lejes mjedisore, formën e aplikimit, përmbajtjen e lejes mjedisore, revokimin e lejes, vazhdimin e vlefshmërisë si dhe regjistrin e lejeve të lëshuara”.*

Sipas nenit 34 të këtij ligji përcaktohet se: *“Masat e rehabilitimit 1. Kur konstatohet ose vërtetohet se personi juridik ose fizik apo autoriteti publik ka shkaktuar dëm mjedisor më qëllim ose nga pakujdesia, e cila rezulton me çrregullime mjedisore, është i detyruar ta kthejë pjesën e dëmtuar në kushtet që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut apo kapacitetit të përgjithshëm rehabilitues të pjesës së dëmtuar. 2. Në rast se personi juridik ose fizik, apo*

autoriteti publik merr pjesë në një aktivitet të vazhdueshëm që mund të sjell dëm të madh apo kritik mjedisor ose aksident mjedisor, ai ka obligim që në afat të caktuar të ndërmarr masa dhe me aktivitetin e tij në të ardhmen: 2.1. të zvogëloj emisionin dhe cilësinë e mjedisit në nivelin e lejuar; 2.2. të minimizoj rrezikun për një aksident mjedisor në pajtim me ligjin. 3. Personi juridik ose fizik apo autoriteti publik nga i cili kërkohet të ndërmarrë masa nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni, është i detyruar ti paraqes Ministrisë planin për masat që duhet ti ndërmerr. 4. Ministria në afat prej tridhjetë ditë duhet t'i përgjigjet palës”.

Sipas nenit 50 të këtij ligji përcaktohet se: “Monitorimi i mjedisit 1. Ministria në kuadër të përgjegjësi të veta të përcaktuara me ligj siguron kontrollin e vazhdueshëm dhe bënë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me këtë ligj, ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit”.

### **Udhëzim Administrativ MMPH - NR.03/2018 për Procedurat për Leje Ujore**

Sipas nenit 15 të këtij udhëzimi përcaktohet se: “Leja ujore sigurohet për të gjitha objektet dhe aktivitetet me të cilat me dispozita ligjore është përcaktuar lëshimi i pëlqimit uJORë, me përjashtim të nxjerrjes së materialit nga ujë rrjedhat dhe rregullimi i ujë rrjedhave dhe ujërave tjera”.

Sipas nenit 17 të këtij udhëzimi përcaktohet se: “1. Kohëzgjatja e lejes ujore është e përcaktuar me nenin 73 të Ligjit. 2. Leja ujore e lëshuar mund të vazhdohet nga organi kompetent i cili e ka lëshuar atë, sipas kërkesës së bartësit të lejes ujore, e cila paraqitet së paku dy muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë së lejes ujore”.

Sipas nenit 18 të këtij udhëzimi përcaktohet se: “1. Ndërprerja e lejes ujore zbatohet nga ana e organit kompetent për lëshimin e akteve ujore për çështjet e përcaktuara me dispozitat e nenit 76 të Ligjit ose inicohet sipas detyrës zyrtare. 2. Leja ujore përveç rasteve të parapara me nenin 76 të Ligjit mund të merret edhe kur: 2.1 Uji shfrytëzohet respektivisht, shkarkohet në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me lejen ujore”.

Sipas nenit 19 të këtij udhëzim përcaktohet se: “Me urdhërese ujore, palës së cilës i është lëshuar leja ujore, i përcaktohen detyra që në afat të caktuar të kryej ndonjë punë, respektivisht që të përmbahet nga ndonjë veprim, për shkak të evitimit të rrezikut ekzistues ose të mundshëm të çrregullimit të regjimit uJOR, respektivisht çrregullimit të shtratit të lumit ose tokës ujore, si dhe vendosja e gjendjes në përputhje me kushtet e lejes ujore”.

### **Udhëzim Administrativ MMPH - Nr.07/2017 për Leje Mjedisore**

Sipas nenit 4 të këtij Udhëzimi përcaktohet se: “Të gjitha veprimtaritë të cilat kanë Pëlqim Mjedisor janë të obliguara të pajisen me Leje Mjedisore, duke përjashtuar veprimtaritë që janë subjekt i Parandalimit dhe Kontrollit të Integruar të Ndotjes si dhe Lejes Mjedisore Komunale”.

Sipas nenit 9 të këtij Udhëzimi përcaktohet se: “1. Për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore, Ministria me vendim cakton komisionin në përbërje prej pesë (5) anëtarëve. 2. Mandati i komisionit nga paragrafi 1. i këtij neni është një (1) vjeçar”.

Sipas nenit 10 të këtij Udhëzimi përcaktohet se: “1. Komisioni shqyrton kërkesën për Leje Mjedisore dhe përgatitë propozim - vendimin në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh, duke

*përfunduar ndonjë periudhe kohore, të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni. 2. Nëse gjatë shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, komisioni konstaton se aplikacioni dhe dokumentacioni nuk është i kompletuar, po kërkohet plotësim i kushteve teknike caktohet një afat i arsyeshëm për kryerjen e veprimeve të mëtejshme. 3. Nëse operatori nuk mund të i plotësoj kushtet në afatin kohor të dhënë nga Ministria, mund të bëjë kërkesë për shtyrje të afatit, pesë (5) ditë para përfundimit të afatit të dhënë nga Ministria në formë elektronike”.*

Sipas nenit 11 të këtij Udhëzimi përcaktohet se: “1. Në bazë të propozim vendimit të komisionit, Ministria lëshon ose refuzon kërkesën për Leje Mjedisore në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh dhe për vendimin e marrë e njofton me shkrim aplikuesin dhe Komunën/ Komunitetin. 2. Nëse operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore i lëshohet Leja Mjedisore. 3. Refuzimi i kërkesës për Leje Mjedisore bëhet nëse operatori nuk i përmbush kushtet teknike dhe mjedisore. 4. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesë (5) vjeçare”.

Sipas nenit 16 të këtij Udhëzimi përcaktohet se: “1. Mbikëqyrjen inspektuese në zbatimin e dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ e bënë inspektorati mjedisor, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. 2. Nëse operatori nuk posedon Leje Mjedisore, inspektori i mjedisit urdhëron operatorin që të filloj procedurën për tu pajisur me Leje Mjedisore, sipas nenit 4. të këtij Udhëzimi Administrativ në afat prej tridhjetë (30) ditëve. 3. Nëse operatori nuk i zbaton kushtet nga vendimi i Lejes Mjedisore, mjedisor me vendim urdhëron inspektori operatorin zbatimin e tyre sipas nenit 11, paragrafi 2. të këtij Udhëzimi Administrativ. 4. Nëse operatori nuk vepron sipas vendimit të inspektorit nga paragrafi 1. të këtij neni, detyrohet të paguaj gjobën në të holla të përcaktuar me Ligjin për Kundërvajtje, Nr.05/L-087”.

### **Rregulla ZRRE/Nr.07/2017, për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, e datës 31 mars 2017**

Sipas nenit 3 të kësaj Rregulle, lidhur me aktivitetet e licencuara, përcaktohet se: “1. Sipas Nenit 28, paragrafi 2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, një licencë e lëshuar nga Rregullatori mund të mbulojë më shumë se një nga aktivitetet e energjisë të mëposhtme: 1.1 prodhimin e energjisë elektrike”.

Sipas nenit 4 të kësaj Rregulle, lidhur me Aplikimi për licencim, përcaktohet se: “1. Aplikimi për licencim, ndryshim, modifikim, bartje (transferim) dhe vazhdim të licencës bëhet me shkrim dhe në formën e specifikuar nga Rregullatori”.

Sipas nenit 5 të kësaj Rregulle, lidhur me procedurën për shqyrtimin e aplikacioneve, përcaktohet se: “1. Procedurat e përcaktuara me këtë Rregull do të zbatohen për të gjithë aplikuesit për licencim, duke përfshirë aplikimet nga të licencuarit ekzistues për ndryshim, vazhdim, bartje (transferim) të një licence aktuale. 6. Aplikuesit për Licencë prodhimi për impiantin i cili është ndërtuar përmes procedurës së Autorizimit, të udhëhequr nga Rregullatori, i cili për arsye objektive, nuk mund të prezantohet dëshminë e përcaktuar me Nenin 9 paragrafi 1.4 të kësaj Rregulle, mund të lëshohet Licencë e përkohshme vetëm një herë, për një periudhë jo më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj”.

Sipas nenit 9 të kësaj Rregulle, lidhur me Kërkesat specifike të aplikimit për licencë të prodhimit: *“1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për prodhim të energjisë elektrike, prodhim të energjisë termike apo bashkëprodhim të energjisë elektrike dhe energjisë termike, përveç kërkesave sipas Nenit 8 të kësaj Rregulle, duhet të dorëzoj në Rregullator edhe dokumentet/dëshmitë si në vijim: 1.3.lejen mjedisore, lëshuar nga institucioni kompetent (aty ku është e aplikueshme)”*.

Sipas nenit 17 të kësaj Rregulle, lidhur me Monitorimin e aktiviteteve të licencuara, përcaktohet se: *“1. Rregullatori monitoron performancën e aktiviteteve të licencuara bazuar në të dhënat e dorëzuara nga i licencuari dhe informatat nga tregu, sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi. 2. I licencuari duhet ti ofroj Rregullatorit të gjitha të dhënat e kërkuara gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës”*.

Sipas nenit 22 të kësaj Rregulle, lidhur me ndërprerjen e licencës, përcaktohet se: *“1. Në pajtim me Nenin 37 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, çdo licencë e lëshuar mund të ndërpritet apo të tërhiqet nga Rregullatori”*.

Në kuptim të këtyre dispozitave të lartcekura, Gjykata Supreme vlerëson se vendimi i të paditurës së parë M.E.A., (MEA) paditurës së dytë Z., Rr.,për E., (ZRRE) janë vendime të drejta dhe të ligjshme dhe në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar. E paditura e parë MEA dhe e paditura e dytë ZRRE kanë zbatuar në tërësi dispozitat nga e drejta materiale në mënyrë adekuate sipas gjendjes faktike të konstatuar në shkresat e lëndës. Vendimet e të paditurave janë hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), si dhe i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara si në nenin 47 dhe 48 të tij.

Vendimet e të paditurës së parë Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit:

Vendimi për leje ujore për HC B, L.U..., .../..., i datës 03.11.2020; Vendimi për Leje Ujore për HC D.,...../....., i datës 04.11.2020; Vendimi për Leje Ujore për HC L.,..., L.U..., .../..., i datës 03.02.2021, janë të drejta dhe të ligjshme dhe në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 71 i Ligjit Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.03/2018 për Procedurën për Leje Ujore.

Vendimi për Leje Mjedisore për HC B, ..../.,ZSP, të datës 06.11.2020; Vendimi për Leje Mjedisore për HC D, ..../., e datës 06.11.2020, janë të drejta dhe të ligjshme dhe në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mjedisin, dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.07/2017 për Leje Mjedisore, dhe përgjegjësitë të MEA-së të përcaktuara si në nenin 2 të Rregullores (QRK) Nr.07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.06/2020 lidhur me përgjegjësitë e MEA-së.

Vendimet e të paditurës së dytë Zyra e Rregullatorit për Energji:

Vendimi V\_1303\_2020, i datës 12.11.2020; Vendimi V\_1304\_2020, i datës 12.11.2020; Licencë për Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC D., Li\_49/20, e datës 12.11.2020 dhe Licencë për Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC B., Li\_50/20, e datës 12.11.2020, janë të drejta dhe të ligjshme dhe në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, neni 15, neni 26, neni 28 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, neni 30, neni 32 paragrafin 2 nën paragrafi

2.1, nenin 34 dhe nenin 38 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, nenin 6 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, nenin 18 të Ligjit Nr.05/L -081 për Energjinë, dispozitat e Rregullës Nr.07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë. Këtyre vendimeve i kanë paraprirë procedurat e rregullta dhe të ligjshme administrative dhe një varg vendimesh të lëshuara në përputhje me Rregullat e ZRRE-së për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja Gjeneruese, si Rregulla e datës 04.11.2008, 29.08.2011 dhe 11.11.2014, të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së tyre.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të paditësve dhe ndërhyrësve në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykatës Supreme i ka rezultuar se pretendimi kryesor i paditësve - ndërhyrësve është se M e E dhe A., (MEA) me shkelje të ligjit ka zbatuar nenin 70 të Ligjit për Ujërat, me ç'rast palës së interesuar K.E., Sh.p.k., i ka lëshuar lejen ujore sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe jo përmes koncensionimit ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 2 të tij, ngase siç thekson në kërkesë leja ujore lëshohet për entitetet publike ndërsa koncesioni aplikohet për entitetet private, dhe si rrjedhojë e këtyre lejeve të kundërligjshme burojnë edhe vendimet e të paditurës së dytë Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Këto pretendime të paditësve - ndërhyrësve, të theksuara në kërkesë, kolegji i Gjykatës Supreme i vlerëson si të pabazuara dhe të paqëndrueshme ngase në asnjërin nga dispozitat e Ligjit Nr.04/L-147 për Ujërat nuk është përcaktuar se leja ujore mund të i jepet vetëm entiteteve publike, ndërsa koncesioni vetëm entiteteve private. Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret procedura e dhënies së të drejtës ujore përmes lëshimit të lejeve ujore nuk përbën shkelje të ligjit ngase në kuptim të dispozitave ligjore nga neni 70 i Ligjit Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës janë përcaktuar dy mundësi për fitimin e së drejtës ujore dhe atë përmes 1.1 lejes ujore, 1.2 me koncesion. Kështu, neni 72 paragraf 1.7 ka përcaktuar se leja ujore lëshohet edhe për përdorimin e ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale.

Për më tepër, në rastin konkret në kuptim të dispozitave ligjore të këtij ligji, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), nuk ka qenë e detyruar, për të hyrë në partneritet publiko - privat, ngase nuk ka pasur për qëllim implementimin e një projekti apo kontrate - marrëveshje publike, ndërsa dispozitat e këtij ligji nuk kanë përcaktuar se leja ujore nuk mund të lëshohet për veprimtaritë afariste ashtu siç pretendojnë paditësit - ndërhyrësit në kërkesë.

Pretendimi i theksuar si në kërkesë, se paditësit - ndërhyrësit, me prova kanë dëshmuar se qasja në ujë për banorët e qytetit të Deçanit është rrezikuar, dhe se ka humbur një burim i ujit të pijes që furnizon banorët e Komunës së Deçanit, se është hedhë shumë material nga gjurmimi i kanalit për vendosjen e gypave në pjesën e poshtme të rrugës nga bregu i lumit, është dëmtuar rrethoja e kaptazhës kryesore prej nga fillon furnizimi me ujë, që është arteria kryesore e furnizimit, se mbi kanal të gypit është hedhur sasi e madhe e materialit nga gjurmimi i kanalit për dislokimin e një gypi, është ngushtuar shtrati i lumit nga materiali i hedhur në bregun e tij, dhe është bërë degradimi jashtëzakonisht i madh në ambient nga eksploatimi i zhavorrit dhe rërës në vendin e quajtur “Z i R”. , pa asnjë dokument nga MMPH, KK Deçan dhe pa asnjë kriter, kolegji i Gjykatës Supreme i vlerëson të pabazuara, ngase paditësit me asnjë provë relevante nuk kanë arritur të provojnë dëmin e pretenduar të shkaktuar, humbjen e burimit të ujit të pijes, apo qasjes në ujë ndërsa nga raportet e prezantuara nuk mund të vërtetohen pretendimet e tyre.

Pala e interesuar, K. E., Sh.p.k, është njoftuar se lejet ujore L.U.,....., dhe L.U., ....., dhe L.U.,,,, ..., të lëshuara nga Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore - MEA, janë dhënë nën kushtet e

monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve të ujit mbi dhe poshtë profilit ujë-marrës, me të cilat regjistrohet prurja natyrore deri në objektin ujëmarrës, dhe prurja e pranueshme ekologjike poshtë profilit ujë-marrës, ndërsa matjet duhet të kryhen me pajisje automatike online dhe pajisjet ujëmatëse vendosen me aprovimin nga IHMK- Instituti Hidrometeorologjik i K., Që si rrjethojë, Profili hidrometrik i tyre i mundëson IHMK-së, monitorimin online të matjeve dhe niveleve dhe prurjeve të ujit, në profilet përkatëse.

Së këndejmi, në kuptim të dispozitave ligjore të lartëcekura por edhe nga Lejet Ujore, pikën 4 dhe 9 të tyre, shprehimisht është përcaktuar se nëse për shkak të shfrytëzimit të ujit të hidrocentralit, vjen deri tek çrregullimi i regjimit ujqor, deri tek proceset eroduese në shtrat të lumit, të objekti ujë-marrës, të objekti prodhues dhe përgjatë gypsjellësit, e kjo shkakton dëme të çfarëdo karakteri, shfrytëzuesi është i obliguar që shkaqet e dëmit t'i eliminoj, kurse dëmet ti kompenzoj dhe në rastet kur mungesa e ujit rrezikon në masë të madhe shfrytëzuesit e ujit në një rajon të caktuar, lëshuesi i lejes ujore përkohësisht mund tua kufizoj ose tua ndaloj, shfrytëzimin e ujërave bartësve të lejes ujore. Çka nënkupton se Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), ka kompetenca dhe autorizime ligjore që pas lëshimit të lejes ujore që të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të bartësit të lejes ujore, në rastin konkret palës së interesuar K. E., Sh.p.k, dhe përkohësisht mund edhe të ia kufizoj apo ndaloj shfrytëzimin e ujërave.

Të pabazuara janë edhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës ku thekson se vendimet për leje mjedisore janë lëshuar në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, sepse bazuar në Raportin e Grupit Punues për shqyrtimin e procedurave administrative nuk është zbatuar neni 10 i Udhëzimit Administrativ 04/2016 për mbrojtjen e brigjeve të ujërrjedhave. Kjo gjykatë nuk mund të pranoj si të drejta pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me konstatimet e Raportit të Grupit Punues për shqyrtimin e procedurave administrative të zbatuara për hidrocentrale dhe ndikimin e tyre në ujëra dhe mjedis, të datës 30 Qershorit 2021, ngase i njëjti është përpiluar nga grupi punues i caktuar sipas vendimit të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe duke pasur parasysh konstatimet dhe të gjeturat e këtij grupi punues, se procedurat e dhënies së lejes ujore, mjedisore apo ndërtimore nuk kanë qenë në harmoni me dispozitat ligjore, dhe operatorët ekonomik nuk i kanë plotësuar kushtet, apo të njëjtit nuk janë duke i përmbushur kushtet për të cilat u janë dhënë këto leje, kjo ministri ka tagër që vetë të i revokoj/ndërprejë këto leje, mirëpo të njëjtat nuk i ka revokuar/ndërprerë.

Në bazë të dispozitave të lartcekura, Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesë vjeçare, nëse pala i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore ndërsa revokimi, shfuqizimi ose pezullimi i lejes mjedisore mund të bëhet në çdo kohë nga MEA në rast se vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore dhe nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore sipas legjislacionit në fuqi. Për më tepër, Ministria në kuadër të përgjegjësisë së veta të përcaktuara me ligj siguron kontrollin e vazhdueshëm dhe bënë monitorimin e gjendjes së mjedisit.

Kjo gjykatë po ashtu nuk mund të pranoj si të drejtë dhe të ligjshëm konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se e paditura e dytë Z., Rr., për E., (ZRRE), ka bërë interpretim të gabuar të nenit 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe ka dështuar që të ndërlihd afatin për dhënien e Licencës për operim me afatin e vlefshmërisë së lejes mjedisore, ngase kjo dispozitë ka përcaktuar qartë kufirin maksimal për të cilin mund të jepet licenca për aktivitetet e prodhimit të



energjisë, e cila kohëzgjatje varet nga jetëgjatësia e aseteve të përdorura për kryerjen e aktiviteteve relevante, mirëpo që nuk tejkalon periudhën dyzet (40) vjeçare. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në asnjërën nga dispozitat ligjore nuk kërkohet ndërlidhshmëria e afateve të licencës me atë të lejes mjedisore ngase secila prej tyre i ka kërkesat dhe specifikat e veta.

Po ashtu, me Vendimet V\_1303\_2020 dhe V\_1304\_2020, të lëshuara nga Rregullatori për licencimin e K.,-it, përveç tjerash, K.E., Sh.p.k është obliguar të dorëzoj në ZRRE çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës, në të kundërtën Rregullatori ka autorizime dhe kompetenca konform dispozitave të lartcekura ligjore, për ndërmarrjen e masave ligjore, përfshirë edhe tërheqjen e licencës.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, e paditura e dytë Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), para gjykatës ka deponuar prova të mjaftueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se janë plotësuar dhe respektuar të gjitha kërkesat që dalin nga legjislacioni në fuqi lidhur me zhvillimin e procedurës së licencimit dhe operimit të ndërmarrjes K.E., Sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë.

Pretendimi i theksuar si në kërkesë, se Gjykata e Apelit ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës parashikuar nga neni 160 par. 4 dhe 184 të LPK-së, përkatësisht se gjykata ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe po ashtu nuk ka arsyetuar mjaftueshëm aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme e vlerëson si të pabazuar ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme për vërtetimin e fakteve vendimtare, përkitazi me ankesat e parashtruara nga të paditurat duke vlerësuar njëherit se pretendimet e tyre të parashtruara si në ankesë janë të bazuara dhe duke konstatuar se vendimet tyre janë nxjerrë në përputhje me dispozitat procedurale dhe materiale dhe në procedurë të ligjshme administrative.

Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë është nxjerrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë, nuk i ka vlerësuar provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe nuk i ka vlerësuar drejtë vendimet e të paditurave. Për më tepër aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë është kontradiktor në vetvete, respektivisht dispozitivi dhe arsyetimi i tij janë kundërtthënës. Gjykata Supreme nuk mund të pranoj si të drejta konstatimet e gjykatës së shkallës së parë ku thekson se paditësit kanë ofruar prova mbi bazën e të cilave vërtetohet eksplotimi dhe degradimi i mjedisit tek vendi i quajtur “Z i R”. dhe konstatimi që gjykata ka detyruar të paditurën që në përputhje me autorizimet e veta ligjore, të mundësoj krijimin e trupave apo mekanizmave ad-hoc, mandati i së cilëve do të ishte identifikimi, raportimi dhe sanimi i të gjitha dëmeve mjedisore të shkaktuara nga pala e interesit, ngase në asnjërën nga pikat e dispozitivit të aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë nuk detyrohet e paditura për ndërmarrjen e një veprimi të tillë. Andaj nga e gjithë ajo që u theksua më lartë, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e Apelit ka vepruar drejtë kur ka aprovuar ankesat e të paditurës MEA dhe ZRRE dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës, gjithmonë duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatim të së drejtës materiale apo shkeljeve të dispozitave të procedurës, por gjen se të njëjtat janë të pabazuara dhe nuk janë të mbështetura në

fakte dhe prova relevante, mbi bazën e të cilave do të mund të provoheshin pretendimet e tyre, andaj edhe nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe në këtë çështje nga çka ka vendosur gjykata e shkallës së dytë. Ndërsa bazuar në nenin 7 paragraf 1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në bazë ligjore me vendosjen e çështjes në mënyrë meritore duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj, dhe duke konstatuar se të paditurat kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat materiale dhe aktet e tyre nuk janë të përfshira me shkelje procedurale.

Gjykata nuk shqyrtoi pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës, lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: *“Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes”*.

Gjykata nuk shqyrtoi pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës, lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: *“Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes”*.

Mbi këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se pretendimet e paditësve - ndërhyrësve si në kërkesë janë të pabazuara dhe të pa ndikim për një gjendje ndryshe faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Vendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, po ashtu edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësve dhe ndërhyrësve.

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 54 paragraf 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË  
ARJ.nr.212/2023, më datë 5 mars 2024

B. Profesionale  
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit  
Ragip Namani